

Ne dhe Tjerët

NUMËR 1 • QERSHOR 2001.

Centar za toleranciju i dijalog
Center for Tolerance and Dialogue

CTD

INTERVISTA

Stiven Larabi, EKSPERT PËR ÇESHTJE USHTARAKE

Menduan
se jemi të marrë

Faqe 4

SHTOJCAT

SINISHA TATALOVIQ

Eliminimi ose
menagjimi i
diferencave etnike

Faqe 8-9-10

JULIE MOSTOV

Etnokratët po e
pengojnë demokra-
tizimin e shoqërisë
në tranzicion

Faq 10-11-12

STEVAN LILIQ

Nga robëria deri
tek mosnënshtrimi
qytetarë

Faqe 15

RADOVAN VUKADINOVIQ

Rruga e vetme deri
në Evropë

Faqe 14-15

Ne dhe Tjerët sjellë:

Programi dhe puna e
Qendrës për Tolerancë e
Dialog

Faqe 2 i 3

Organizimi i bashkësive
lokale dhe i pakicave

Faqe 6 i 7

KRYEARTIKULLI

QENDRA PËR TOLERANCË E DIALOG

Ne dhe Tjerët

Rënja e regjimeve komuniste në mbarë Evropën Lindore dhe në ish RSFJ, e rrjedhimisht edhe në Mal të Zi, ka hapur një varg çështjesh të funksionimit të shoqërive, veçmas në dritën e fakteve se akoma nuk janë inauguruar procedura dhe instrumente për menagjimin e konflikteve me interese të ndryshme. Në mjediset e përziera kombëtare, kulturore dhe religjioze çfarë është Mali i Zi, si veçanërisht e rëndësishme është imponuar çështja e multiethnicitetit, multikulturalitetit dhe multikonfesionalitetit të jetës e cila figurativisht mund të përmbledhet në sintagmen - Ne dhe Tjerët

Të ballafaquar me mungesën e institucioneve të shtetit dhe me instrumentet për artikullimin dhe pajtimin e intereseve të ndryshme nga njëra anë, dhe të mungesës së kulturës së përgjithshme veçmas të asaj politike e të tolerancës që doemos e imponon jeta në mjediset shumëkombëtare, shumëkulturore dhe shumëkonfesionale nga ana e tjetër, Shtëpia e Rinisë „Budo Tomoviq“ në Podgoricë dhe Forumi për Marrëdhënie Etnike në Beograd e hüdhen idenë dhe themeluan Qendrën për Tolerancë e Dialog (QTD) me seli në Podgoricë.

Qendra paraqet plotësimin e spektrit të gjërë të organizatave joqeveritare me theks në arsimimin për zgjidhjen demokratike të konflikteve dhe për jetë duke njohur, pranuar dhe respektuar dallimet. Gjithashtu, shtrirja dhe begatimi i bashkëpunimit joqeveritarë ndërkombëtarë është me interes vendimtarë për zhvillimin e shoqërisë civile dhe demokratizimin e reformën e përgjithshme në Mal të Zi.

Objektivat themelore të QTD janë definuar me vet shkaqet për themelimin e saj, kurse operativisht mund të ndahen në disa tërësi. Parësore është puna në grumbullimin, përpunimin, ruatjen dhe këmbimin e infor-

macioneve me domethënje të veçant për studimin dhe përcjelljen e marrëdhënieve brendaetnike, sidomos të konflikteve, me theks në rrugët e vendosjes dhe të zhvillimit të jetës në tolerancë. Posaçërisht është i rëndësishëm edukimi i të rinjve dhe mbështetja njerëzve të rinj të gatshëm për të shtytur vazhdimin dhe shtrirjen e kulturës së dialogut e të tolerancës. Puna e QTD nënkupton edhe intensifikimin e bashkëpunimit, ndërlihdjen e bashkësive të ndryshme etnike, konfesionale e tjera dhe të oraganizatave të tyre.

Me rëndësi të jashtëzakonshme është fisnikrimi i komunikimit në mjediset me konflikte dhe paralajmërimi i rrethanave e sjelljeve që çojnë në shkallëzimin e konflikteve të shkaktuara në bazë të dallimeve etnike, konfesionale ose kulturore.

Ne dhe Tjerët, trimujore e Qendrës për Tolerancë e Dialog numri i parë i së cilës është para jush, është menduar si pjesë e kësaj përpjekje për vendosjen e mirëkuptimit e të jetës tolerante të bashkësive të ndryshme me theks në grupet pakicë dhe të drejtat e tyre. Me prezantimin e projekteve të QTD, tani më të zbatuar por edhe të atyre në përgaditje, Ne dhe Tjerët ka ambicje të bëhet tribunë publike dhe profesionale e cila do të regjistrojë pa anime ecjet pozitive e negative drejtë multiethnicitetit, multikulturalitetit dhe multikonfesionalitetit në Mal të Zi. Puna e organizatave joqeveritare për inaugurimin e parimeve të reja demokratike dhe për inicimin e institucioneve të mbështetura në to - sikur na mëson përvoja e vendeve të zhvilluara dhe e vendeve të cilat shumë më përpara Malit të Zi kanë hyrë në procesin e mundimshëm të tranzicionit - nuk mund të realizohet lehtë pa veprimtari të veçant informative e botuese. Aq më parë kur bile edhe mediat demokratike verbale dhe të hapura bukur shpesh janë të mbyllura ose në rastin më të keq rigjide për konfliktet por edhe për vet jetën e bashkësive të ndërlikuara.

Ne dhe Tjerët do të orvatet që pjesërisht të mbulojë këtë „gropë“ informative, por një ambicje e tillë çftë edhe pjesërisht, nuk është e mundshme të realizohet pa informacion kthyes i cili para se gjithahs nënkupton ide, përvoja dhe sugjerime të lexuesve.

Redaksia

Me kryeartikull

Ndihma e miqve dhe e bashkëpunëtorëve: Botimin e numrit të parë të revistës „Ne dhe Tjerët“ e ndihmuan Westminster Foundation for Democracy me seli në Londë, dhe SIDA - Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Kooperim e Zhvillim, me seli në Stokholm.

Prej robërisë deri të mosnështrimi qytetar

Individualiteti i qenjes njerëzore dhe pavarësia e personalitetit të tij janë bazë për ndërtimin e korpusit të drejtave të njeriut

Prof. Dr. Stevan Liliq

Ideja e të drejtave të njeriut paraqitet në forma nga më të ndryshmet të jetës dhe të krijimtarisë së njeriut, midis tjerash në artt e letërsisë, legjislacione dhe drejtësi, filozofi e religjion, adete e politikë, etj. Edhe pse ideja e të drejtave të njeriut e ka bazën e vet të ndërlkuar filozofike, megjithatë dy nocione qëndrore të filozofisë së të drejtave të njeriut janë të zakonshme dhe lehtë të kuptueshme. Këto janë nocionet e individualitetit të qenjes së njeriut dhe të pavarësisë së personalitetit të tij. Njeriu është kuptuar si qenje që ka pushtet mbi sjelljet e veta dhe tek i cili shkaku i veprimit gjendet para se gjithash në vetë atë.

Rrënjët në mitet greke

Ndonse rrënjët e të drejtave të njeriut mund të gjenden qysh në mitet antike greke, mund të thuhet se mendimi modern mbi të drejtat e njeriut lind paralel me zhvillimin e iluminizmit dhe të univerzalizmit të kohës së re... lufta për atë se disa të drejta dhe liri themlore të njeriut nuk i gëzojnë vetëm qytetarët e një shteti. por të gjithë njerëzit, ka filluar në realitet qysh në shekullin e XVIII, me miratimin e Deklaratës mbi të drejtat e njeriut e të qytetarit në fillim të Revolucionit francez të vitit 1789, sepse ai nuk ka qenë dokument që ka pasur të bëjë vetëm me Francën. Por megjithatë, sovraniteti i shtetit ka qenë aq i fuqishëm sa që ka diktuar bashkëkzistimin e shteteve jodemokratike e demokratike dhe të qeverive të cilat nuk kanë respektuar dhe kanë shkelur drejtat e njeriut. Konsiderohej se raporti midis regjimit dhe vazalëve të tij ka qenë çështje e brendëshme e shtetit ku askush nga jashtë, e më pak organët zyrtarë, nuk ka mundur të implikohet. Për këtë shkak në shekullin e XIX janë kërkuar „pikat e dobëta“ të sistemit të atëherëshëm ndërkombëtarë në ato fusha të cilat nuk kanë qenë të mbuluara me sovranitetin e shtetit. Njëra nga hapsirat e tilla ka qenë, bie fjala, deti i hapur, për çka luftetarët kundër robërisë, në pamundësi që të kontribuojnë në pezullimin e kësaj dukurie jashtë kufijve të shtetit të vet, janë orvatuar të paktën ta pengojnë trëgëtinë me robër, që ka ofruar mundësi që anijet të cilat kanë transportuar robër të ndalen në det të hapur dhe njerëzit e ngujuar të lirohen.

Ideja mbi të drejtat e njeriut kanë pasur, e kanë edhe sot, influencë në botëkuptime dhe nocione të shumta juridike si në teori ashtu edhe në praktikën kombëtare e ndërkombëtare juridike. Kështu, bie fjala, derisa dikur me rastin e ekzekutimit të denimit është konsideruar se njeriu gjatë vuajtjes së denimit është bërë njëfarë lloji i „robër të shtetit“ sot...me shtimin e respektimit të drejtave të njeriut si



primare, nuk theksohet ajo qasje administrativojuridike, veçse edhe këtu pikënisje është respektimi i parimeve themelore të shtetit ligjor dhe cekeni bazat kushtetuese juridike për përcaktimin e autorizimeve për këtë detyrim, dhe për të gjitha operacionet në regjimin e ekzekutimit të denimit të privimit nga liria, që kanë të bëjnë me statusin juridik të të burgosurit.

E drejta ekziston para dhe jashtë shtetit

Mund të thuhet se presupozimet e sotme teorike të drejtave të njeriut si mjet më i lartë i të drejtave në fillim të shekullit të XX, i ka formësuar Leon Digi. Presupozimi i tij kryesor konsiston në konceptin se shteti duhet dhe mundet të kufizohet me të drejtën, si të brendëshme ashtu edhe ndërkombëtare. Sipas logjikës së këtij qasje ndaj të drejtës duhet të ekzistojë „para dhe jashtë“ shtetit (i ashtuquajtur „l'antériorité et l'exteriorité du droit par rapport à l'Etat“). Digi, botkuptimin e vet mbi shtetin e kufizuar me drejtësi e ka paraqitur në veprën e ve „Transformimi i të drejtës publike“ (Le Transformations de Droit Public, 1913), në të cilën, përpos tjerash teoritikisht e „rrezon“ konceptin e të drejtës publike të mbështetur në nocionin e sovranitetit të popullit mbi të cilin edhe konsiston modeli tradicional i shtetit ligjor (Rechtsstaate). Sikurse thekson Digi, „...sistemi i të drejtës publike, nën të cilin tërë një shekull kanë jetuar të gjithë popujt e arsimuar, mbështetur mbi disa parime që deri vonë shumë i kanë respektuar si dogma dhe kanë dashur t'ua imponojnë të gjithëve. Dy ide kryesore ia kanë bërë esencën: ideja e sovranitetit të shtetit bartës i vërtetë i të cilit është populli i kuptuar si shtet, dhe ideja e të drejtës natyrore të individit e cila është e patjetërsueshme dhe e pavjetruar, por e cila i kundërvehet të drejtës sovraane të shtetit. Njëkohësisht, Digi përfundon: „... sot po shihet se e drejta publike nuk mund të shpjegohet me konceptin mbi

delegacionin e sovranitetit nga ana e popullit. Shkaku i kësaj është që vullneti i popullit është vetëm një fiksjon me që, çka do që mendojmë ne, ai në realitet është vetëm vullneti i disa individëve. Për këtë shkak detyrimi i përgjithshëm të cilin koha moderne ua imponon drejtuesve, ashiqare është në kundërshtim me nocionin e sovranitetit. Sipas kësaj, parimi i përgjithshëm i sistemit të drejtës publike moderne reduktohet në këtë: ata, të cilët në realitet e mbajnë pushtetin, nuk kanë të drejtë subjektive për pushtet publik, veçse kanë detyrë për ta përdorur autoritetin e vet për organizimin e shërbimeve publike dhe për të siguruar e kontrolluar punën e tyre.

Teoria e Digi mbi transformimin e pushtetit publik (si e drejtë e urdhërimit) në shërbim përgjegjës publik, ka pasur për pasojë

Gjykimi në Nyrnberg si kthesë

Kthesa në zhvillimin e të drejtave të njeriut paraqitet pas Luftës së Dytë Botërore. Në këtë kontekst rolin e veçantë e ka luajtur Karta e Kombëve të Bashkuara (1945) si dhe gjykimi në Nyrnberg për krime kundër njerëzimit dhe paqes (1946). Gjykimi në Nyrnberg tregon se në vend të vazalit të shtetit, njeriu u parqiti si subjekt i të drejtës univerzale ndërkombëtare dhe se shtetet nuk mund të llogarisin më në sovranitetin e vet legjislativ si bazë për shtypjen dhe shkeljen e të drejtave të përgjithshme të njeriut. Shpejtë pas kësaj u miratua edhe një numër i dokumentave ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut të cilat, midis tjerash, hudhin hemelet dhe standardet e mbrojtjes e të realizimit të tyre. Deklarata e përgjithshme mbi të drejtat e njeriut të KB (1948); Konventa evropiane mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore (1950); Pakti mbi të drejtat civile e politike të KB (1966); Pakti mbi të drejtat ekonomike, sociale e kulturore të KB (1966) e tjera.

Në këtë kuptim, edhe shteti bashkëkohorë mbështetet mbi parimet e sundimit të së drejtës e cila nënkupton integrimin konceptual të parimit tradicional të shtetit ligjor me standardet bashkëkohore të drejtave të njeriut dhe të shtetit social.

që parimi i ligjëshmërisë si parim sipror i shtetit ligjor tradicional, ia ka lënë vendin parimit të drejtave të njeriut si standard më të lartë të shtetit bashkëkohor social. Si garancë institucionale e realizimit dhe e mbrojtjes së të drejtave të njeriut e të drejtës sociale në planin politik, lindin edhe idetë mbi mosnështrimin qytetar si akt politik që midis tjerash... i udhëhequr dhe i justifikuar me principet politike, pra me parimin e të drejtës me të cilën rregullohen kushtetuta dhe institucionet shoqërore në përgjithësi. ■